



Duke u bazuar në nenin 43, 45 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenin 47 të Statutit të Komunës së Klinës Nr. 01-110-1232/2010. Nenin 5 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës si dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

F T E S Ë

Ftohën të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit e tjerë që të marrin pjesë në seancën e **XI-të të rregullt të punës së kuvendit për vitin 2023**.

Seanca mbahet më **22.12.2023 (e Premte)**, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon në orën **10:00**.

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së. Për këtë seancë propozohet ky:

R E N D I I D I T Ë S:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimeve të Komitetit për Politik dhe Financa,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-planit të punës së kuvendit dhe kalendarit për mbajtje të mbledhjeve për vitin 2024,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-listës së përgjithshme të pronave të cilat parashihen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2024 (ref. ekz),
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-listës së veçantë të pronave të parashihen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2024 (ref.ekz),
7. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-strategjisë për zhvillim ekonomik, lokal për Komunën e Klinës 2024-2029 (ref.drejt.fin.),
8. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-planit të punës së ekzekutivit për vitin 2024 (ref. ekz),
9. Shqyrtimi dhe miratimi i planifikimit të prokurimit për vitin 2024 (ref. z. prokurimit),
10. Shqyrtimi i raportit të punës së KKSB-së për vitin 2023 (ref. nga KKSB),
11. Shqyrtimi i raportit të Komitetit për Komunitete për vitin 2023 (ref. nga K. Komunitete),
12. Shqyrtimi i propozimit për falje të qirasë komunale sipas propozimit të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim (ref. drejt. fin),
13. Raportim i kryetarit të komunës për rrjedhat e qeverisjes, të arriturat, vështirësitë dhe investimet kapitale në gjashtëmujorin e dytë 2023,
14. Pyetje dhe përgjigjeje.

01Nr. 06-41721 2023
Klinë, me 22.12 2023



Kryesuesi,
Fadil Gashi